



USAID
ОД АМЕРИКАНСКИОТ НАРОД

KODI PËR TRANSPARENCË NË NIVEL LOKAL

shtator 2022

Ky Kod për transparencën në nivel lokal është përgatitur nga prof. dr. Memet Memeti, në kuadër të Projektit të USAID-it për Forcimin e kapaciteteve për shfrytëzimin të resurseve, me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e shprehur në këtë dokument nuk pasqyron pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

HYRJE

Kodi për transparencë në nivel lokal përmban standarde minimale për informimin proaktiv të publikut për punën e organeve të komunës, për shërbimet që ofron komuna nëpërmjet shërbimeve publike si dhe informacione të tjera që krijon ose me të cilat disponon komuna.

Standardet për transparencë minimale në nivel lokal janë krijuar në bazë të detyrimeve ligjore që dalin nga Ligji për vetëqeverisjen lokale, Ligji për qasje të lirë të informatat e karakterit publik, Ligji për përdorimin e të dhënave të sektorit publik dhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe nga detyrimet e komunave që rrjedhin nga kompetencat e tyre për mbajtjen e regjistrave dhe evidencave si dhe të dhëna statistikore që kanë të bëjnë me territorin e komunës.

Në të njëjtën kohë, është marrë parasysh edhe interesi i qytetarëve/organizatave qytetare për marrjen e informacioneve dhe të dhënave të caktuara që janë të rëndësishme për ta për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe për përfshirjen e tyre në proceset e krijimit të politikave në nivel lokal si dhe informatat që qytetarët konsiderojnë se do t'ua lehtësojnë qasjen deri tek shërbimet publike. Gjithashtu janë të përfshira informata/të dhëna për të cilat komuniteti afarist ka shfaqur interes, veçanërisht për publikimin e tyre në format të hapur, me synim përdorimin e tyre për krijimin e aplikacioneve të dobishme për qytetarët dhe për zhvillimin e bashkësisë lokale.

Qëllimi është që duke zbatuar këto standarde të sigurohet qasje e njëjtë ndaj informatave në të gjitha komunitat në një mënyrë të parashikueshme, duke përmbushur standardet minimale edhe në nivelin teknik.

Sipas Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik, ueb faqja e komunës është mjeti bazë për informimin e publikut në të cilën duhet të jenë të publikuara të gjitha informatat me karakter publik. Duke vepruar kështu, duhet pasur parasysh sigurimin e qasjes në internet në mënyrën më të lehtë dhe më të shpejtë, dukshmërinë e kategorive të informacionit në menynë kryesore, me qasje në të gjitha kategoritë e informacionit në një klikim të dytë. Të dhënat duhet të përditësohen rregullisht, me një qasje të veçantë në varësi të specifikave të çdo informacioni dhe nevojës për t'u përditësuar çdo ditë, ose menjëherë pasi të paraqitet nevoja.

Gjithashtu rekomandohet edhe përmbushja e nivelit AA për qasje në ueb, në mënyrë që të sigurohet qasje e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara të cilët përdorin teknologjitë ndihmëse për të punuar me kompjuterë dhe Internet¹. Informatat dhe të dhënat e publikuara këshillohet të publikohen të ndara sipas gjinisë, aty ku është e mundur.

¹ <https://www.w3.org/WAI/intro/wcag>

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë në informatat publike, si dhe Ligjit për përdorimin e të dhënave nga sektori publik dhe Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, është përgatitur:

KODI PËR TRANSPARENCË NË NIVEL LOKAL

Lënda

Neni 1

Ky kod përshkruan standardet minimale për transparencë të njësive të vetëqeverisjes lokale për publikimin e të dhënave dhe informatave në ueb faqen e komunës.

Me "të dhëna" nënkuptohen të dhëna objektive, faktike, mbi të cilat bazohen vendimet e pushtetit lokal dhe mbi bazën e të cilave vlerësohen shërbimet publike, ose që mblidhen ose krijohen gjatë ofrimit të shërbimeve publike. Këto të dhëna janë bazë për publikimin e informatave mbi kryerjen e funksioneve dhe kompetencave të pushtetit lokal.

Qëllimi

Neni 2

Qëllimi i këtij kodi është përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së njësive të vetëqeverisjes lokale duke përcaktuar burimin kryesor të informatave si dhe strukturën e informatave që duhet të publikohen.

Parimet

Neni 3

Parimet kryesore për qasshmërinë e të dhënave/informatave të cilat janë lëndë e Kodit janë:

- **Të nxitur nga kërkesa** – komuna ka një kuptim për të dhënat që zotëron, njeh vlerën e të dhënave që zotëron, e di se çfarë i nevojitet bashkësisë lokale dhe i publikon të dhënat në një mënyrë që do t'i lejojë publikut t'i përdorë ato pa pengesa. Qytetarët presin që me zhvillimin e teknologjive të reja dhe publikimin e të dhënave të rritet transparenca dhe llogaridhënia në funksionimin e komunës;
- **Të qenit të hapur** – ofrimi i të dhënave publike është pjesë përbërëse e punës së pushtetit vendor me qytetarët dhe inkurajon llogaridhënien dhe përgjegjësinë ndaj tyre. Publiku është i informuar për qasshmërinë e të dhënave dhe di si të qaset deri tek e dhëna dhe si ta shfrytëzojë atë;

- **Në kohë** - afati kohor i publikimit të të dhënave publike është me rëndësi jetike. Të dhënat janë të dobishme vetëm nëse janë në kohë, ndaj publikohen sa më shpejt që të jetë e mundur pas krijimit të tyre, edhe nëse nuk shoqërohen me analiza të hollësishme.

Të qenit publik gjatë punës

Neni 4

Organet e komunës (kryetari i komunës dhe këshilli), komisionet e këshillit dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna janë të detyruara t'i informojnë qytetarët për punën e tyre si dhe për planet dhe programet që janë të rëndësishme për zhvillimin e komunës, në mënyrë të përcaktuar me statut.

Neni 5

Komuna është e detyruar që t'u ofrojë qytetarëve qasje deri tek informatat themelore për shërbimet që ajo ofron.

Transparencë aktive

Neni 6

Ueb-faqja e komunës është mjeti bazë për informimin e publikut në të cilën duhet të jenë të publikuara të gjitha informatat me karakter publik.

Çdo komunë duhet të ketë ueb faqen e saj funksionale e cila do të plotësonte standardet themelore teknike.

Komuna ka për detyrë të informojë opinionin përmes ueb faqes së saj.

Neni 7

Komuna është e detyruar të mundësojë qasje të lirë të informatave të shpallura në ueb faqen e saj.

Neni 8

Komuna shpall të gjitha informatat në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët tjera që janë në përdorim zyrtar në komunë, në mënyrë identike.

Përderisa komuna ka mundësi, informatat i shpall edhe në gjuhën angleze.

Struktura dhe organizimi i informatave të karakterit publik

Neni 9

Informatat publike që i krijon dhe e të cilat disponon komuna, në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informata publike, publikohen në ueb faqen e komunës.

Neni 10

Informatat e publikuara në ueb faqen janë të organizuara në kategori dhe nënkategori².

Neni 11

Në ueb faqe publikohen së paku kategoritë dhe nënkategoritë e informatave në vijim:

1. Kategoria „**Për komunën**“ përfaqëson profilin e komunës, në të paraqiten simbolet e komunës (stema, flamuri, ditët e komunës etj.), pozicioni gjeografik i komunës, duke përfshirë rajonin planor, së bashku me komunat e tjera që i përkasin atij rajoni planor, karakteristikat demografike të komunës, monumentet e rëndësishme kulturore dhe historike dhe specifikat natyrore. Kjo kategori ofron edhe informata për vizionin për zhvillimin e komunës, duke theksuar parakushtet e saj natyrore, ekonomike, sociale dhe të tjera që përcaktojnë rritjen dhe zhvillimin e saj. Në këtë kategori paraqiten gjithashtu edhe të dhënat statistikore për subjektet afariste me karakteristikat dhe informacionet e tyre që mund të paraqesin atraktivitetin e komunës si restorante, muze, objekte kulturore etj. Kjo kategori mund të përmbajë gjithashtu edhe dy nënkategori:
 - **Stema dhe flamuri i komunës;** dhe
 - **Bashkësitë lokale dhe urbane në territorin e komunës,** me të dhëna për emrat e bashkësive lokale apo urbane, kompetencat dhe anëtarët e tyre, informata kontakti dhe formular për paraqitjen e nismave nga qytetarët në BL ose BU.
2. Në kategorinë „**Organet e komunës**“ publikohen informacionet më të rëndësishme për kryetarin dhe këshillin e komunës, duke përfshirë edhe kompetencat që dalin nga Ligji për vetëqeverisjen lokale.
 - Nënkategoria "**Kryetar i Komunës**" përfshin një biografi të shkurtër me të dhëna për datën e marrjes së detyrës, përkatësinë politike, të dhënat personale, shkallën e arsimit, përvojën profesionale, aftësitë, fotografi, numër telefoni dhe adresën elektronike për kontakt, informacione për mënyrën e komunikimit me qytetarët (dita e pranimit, mjeti elektronik, etj.), detyrimisht me vegëz deri tek pyetësi i publikuar në faqen e Agjencisë për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, paga neto, kompetencat.
 - Nënkategoria "**Këshilli i Komunës**" përfshin të dhëna për anëtarët e këshillit, individualisht, emri dhe mbiemri, fotografia, numri i telefonit dhe email adresa e kontaktit, përkatësia politike, niveli arsimor, statusi profesional (i punësuar-i papunë dhe ku është i punësuar) si dhe informacione lidhur me funksionimin e këshillit, për kompetencat e këshillit, kalendarin

²Kategoritë janë të shënuara me numra të zeza: 1, 2, 3,Nënkategoritë janë të shënuara me pika

për shpalljen e seancave të këshillit, rendin e ditës së seancës së shpallur të këshillit, procesverbalet e seancave etj.

- Nënkatgoria "**Komisionet/Organet e këshillit komunal**" përfshin të dhëna për emrin e komisionit, anëtarët e komisionit, rregulloren e punës dhe dokumentacionin në lidhje me punën e tyre.
3. Kategoria "**Komisionet/Organet e komunës**" përmban informacione dhe dokumentacion lidhur me punën e të gjitha komisioneve dhe organeve, të cilat nuk janë organe të këshillit, por janë formuar në përputhje me ligjin dhe funksionojnë brenda komunës, të shënuara në nënkategori:
- **Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (nëse komuna është e obliguar me ligj të formojë komision),** publikon informacion për anëtarët e komisionit (emri dhe mbiemri me kontaktet e e-mail, telefonit), programi vjetor i punës, aktivitetet aktuale, raport vjetor për punën e komisionit, procesverbal nga mbledhjet, formulari për paraqitje të iniciativave nga qytetarët apo organizatat e shoqërisë civile.
 - **Këshilli për mbrojtje të konsumatorëve** publikon informacion për anëtarët e këshillit (emri dhe mbiemri me kontaktet e e-mail, telefonit), programi vjetor i punës, aktivitetet aktuale, raport vjetor për punën e komisionit, procesverbal nga mbledhjet, formulari për paraqitje të iniciativave nga qytetarët apo organizatat e shoqërisë civile.
 - **Organ konsultativ nga fusha e urbanistikës**
 - **Komisione/organet e tjera të komunës**
4. Kategoria "**Administrata**" përmban informacione rreth:
- **Organizimit dhe strukturës së administratës** me publikimin e rregullores në tabelë për organizimin e brendshëm dhe rregullave për sistemimin e vendeve të punës, organogramin e komunës dhe strukturën e të punësuarve sipas pozitave, etnisë dhe gjinisë;
 - **Sekretarja e komunës,** me biografi profesionale, numër telefoni dhe e-mail;
 - **Lista e të punësuarve,** e organizuar sipas sektorëve dhe departamenteve me numrat e telefonit kontaktues dhe e-mail;
 - **Lista e personave të punësuar përkohësisht,** me emër dhe mbiemër, për çfarë periudhe kohore është punësuar personi, për cilat detyra dhe kompensim;
 - **Punësime** me publikimin e planit vjetor të punësimit, njoftime për punësim, vendime për përzgjedhjen pas shpalljeve të publikuara për punësim.
5. Kategoria "**Informatorët zyrtarë të komunës**" përmban të gjitha gazetatat zyrtare të komunës që mund të kërkohen sipas numrit, datës apo emrit të aktit.
6. Kategoria "**Dokumente**" përmban të gjitha dokumentet strategjike dhe programore të komunës, raportet vjetore dhe tremujore, rregulloret, urdhëresat, udhëzimet, programet, vendimet, zgjidhjet dhe aktet e tjera të rëndësishme, të cilat mund të organizohen në nënkategori sipas zonave. Buxheti dhe statuti, si dokumentet më të rëndësishme të komunës, janë të disponueshme dhe të dukshme më së shumti me një klikim të dytë.
- Në nënkategorinë "**Statuti i Komunës**" publikohet teksti i konsoliduar i dokumentit.

- Në nënkategorinë **“Buxheti i komunës”** , publikohet kalendari buxhetor i komunës, qarkorja buxhetore, programet buxhetore dhe informacioni për realizimin e buxhetit të komunës. Propozim-buxheti i komunës, buxheti i komunës i cili është miratuar nga këshilli i komunës, si dhe të gjitha ndryshimet dhe shtesat në buxhetin e komunës (ribalanci) publikohen me deklaratë të veçantë që përmban të dhëna për vlerën totale të të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara, krahasimi i tyre me periudhën e kaluar, vlera e të hyrave dhe shpenzimeve sipas programeve buxhetore, fatura dhe zëra, shpjegim për rritje apo ulje të mundshme dhe në lidhje me cilat pozicione, përfitimet e pritura për qytetarët, iniciativa të qytetarëve të përfshira etj. Është e dëshirueshme që buxheti i komunës të publikohet në një formë lehtësisht të kuptueshme për publikun e gjerë, pra në formën e një buxheti qytetar. Informatat për realizimin e buxhetit të komunës publikohen në formë të raporteve financiare periodike, gjegjësisht raporteve financiare mujore ose tremujore, duke përfshirë raportet për gjendjen e obligimeve dhe borxhit të komunës si dhe raportet vjetore për realizimin e buxhetit të komunës, d.m.th. llogaritë përfundimtare për komunën dhe për shfrytëzuesit e buxhetit komunal dhe llogarinë vjetore (të konsoliduar) të buxhetit të komunës së bashku me raportin vjetor për funksionimin e komunës. Raportet e realizimit të buxhetit, nëse është e mundur, publikohen dhe përpunohen grafikisht sipas praktikës së mirë të publikimit të tyre në ueb faqen e Ministrisë së financave (banderola "Treguesi financiar" - <https://indikatori.opstinskisoveti.mk/>).
- Në nënkategorinë **“Dokumentet strategjike dhe programore”** publikohen të gjitha dokumentet strategjike (strategji, programe, plane etj.), si strategjia për zhvillimin ekonomik lokal, strategjia për arsimin, strategjia për të rinjtë, plani për mobilitet urban, plani për mbrojtje dhe shpëtim, programi për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personave të dalluar me përkujtime për një periudhë 5 vjeçare, plani për veprimet lokal për mjedisin, programet vjetore sipas zonave dhe plane për veprim dhe të tjera strategjike të krijuara nga komuna.
- Nëse komuna ka deklaruar paqëndrueshmëri financiare, sipas Ligjit për financim të NJVL-ve, në nënkategorinë e veçantë **“Plani i masave për tejkalimin e paqëndrueshmërisë financiare”** publikohet plani i masave për tejkalimin e paqëndrueshmërisë financiare dhe të gjitha aktet përkatëse.
- Në një nënkategori të veçantë **"Raportet e revizionit"** publikohen të gjitha raportet e Entit shtetëror për revizion (EShR), me raportet e komunës për veprim sipas rekomandimeve të EShR-së, si dhe raportet e revizionit të përgatitura nga shtëpitë e pavarura të jashtme për revizion.
- Raportet tremujore për **mbikëqyrje inspektimi** në territorin e komunës nga shërbimet e inspektimit komunal publikohen në nën kategorinë **"Mbikëqyrje inspektimit"**.
- Në nënkategorinë **"Dokumentet e tjera"** publikohen akte dhe dokumente të tjera komunale që nuk përfshihen në asnjërën nga nënkategoritë e sipërpërmendura dhe janë lëndë për t'u ndarë me publikun e gjerë, si për shembull dokumentacioni për koncesione, informacione, kontrata dhe raportet për partneritetet publiko-privat etj.

7. Kategoria "**Shërbime**" përmban të gjitha informatat për shërbimet që siguron komuna sipas kompetencave të saja si dhe mënyrën se si qytetarët mund të marrin shërbimin, me shpjegim të saktë për të gjithë formularët dhe kontaktet deri tek personat zyrtar përgjegjës për sigurimin e shërbimit. Kategoria mund të organizohet në dy nënkategori:
 - **Katalogu i shërbimeve**, i cili përmban të gjitha shërbimet e ofruara nga komuna për qytetarët, sektorin/departamentin përgjegjës, personin përgjegjës, detajet e kontaktit të personit përgjegjës, mënyrën e ofrimit të shërbimit (dokumentet e nevojshme dhe mënyra e paraqitjes së tyre), formularët, me një vegëz deri te shërbimi nëse është i disponueshëm në mënyrë elektronike; si dhe
 - **E-shërbime**, me përshkrim të saktë të shërbimit si dhe mënyrën e sigurimit të saj.
8. Kategoria "**Taksat dhe tarifat lokale**" përmban informata për të gjitha taksat dhe tarifat lokale që ka komuna duke publikuar aktet që përcaktojnë shumën e tatimit/taksës, metodologjinë e llogaritjes së tatimit/taksës, mënyrën e pagesës, formularin për paraqitje të ankesës dhe dokumente të tjera. Kalendarin e aktiviteteve tatimore si dhe njoftimet e ndryshme, fushatat, fletëpalosjet, shpalljet, etj. në lidhje me aktivitetet e ndërmarra nga komuna për administrimin e tatimeve dhe tarifave lokale publikohen gjithashtu në këtë pjesë.
9. Kategoria "**Prokurime publike dhe Thirrjet publike**" mund të organizohet në dy nënkategori:
 - **Prokurime publike** përmban të gjitha informatat rreth të gjitha prokurimeve publike të komunës me të gjithë dokumentacionin e publikuar në Portalin e vetëm elektronik të prokurimit publik të Byrosë për prokurim publik, me publikimin në faqen e internetit të komunës në vegëzën e cila çon drejtpërdrejt në prokurimet publike të komunës. Në këtë nënkategori gjithashtu publikohet plani vjetor për prokurime publike dhe të gjitha amendamentet, si dhe raporti vjetor mbi zbatimin e planit për prokurim publik;
 - **Thirrje publike**, përmban të gjitha thirrjet publike të publikuara nga komuna.
10. Kategoria "**Projektet në territorin e komunës**" përmban informata për të gjitha projektet aktuale që realizohen në komunë, pavarësisht nëse financohen me mjete nga buxheti i komunës, nga buxheti i shtetit apo nga fonde donatorësh. Për shkak të transparencës më të madhe, informatat mund të organizohet në disa nënkategori:
 - **Projektet e financuara nga komuna**, me informata mbi datën e fillimit të projektit, datën e parashikuar të përfundimit, vlerën e projektit, bashkëfinancimin e mundshëm, kontraktorin, një përshkrim të shkurtër të projektit dhe përfitimet për qytetarët (mbështetur me të dhëna), të dhënat për personin përgjegjës nga komuna për monitorimin e projektit (numri i telefonit për kontakt dhe adresa e e-mail-it), si dhe kontaktet për raportimin e ankesave të mundshme në lidhje me realizimin e projektit;
 - **Projektet e financuara nga shteti**, me informata mbi datën e fillimit të projektit, datën e parashikuar të përfundimit, vlerën, bashkëfinancimin e mundshëm nga komuna, kontraktorin, një përshkrim të shkurtër të projektit dhe përfitimet për qytetarët (mbështetur me të dhëna), të dhënat për personin përgjegjës nga komuna për monitorimin e projektit

(numri i telefonit për kontakt dhe adresa e e-mail-it), si dhe kontaktet për raportimin e ankesave të mundshme;

- **Projektet e financuara nga bashkësia donatore**, me informata mbi datën e fillimit të projektit, datën e parashikuar të përfundimit, vlerën, bashkëfinancimin e mundshëm nga komuna, kontraktorin, një përshkrim të shkurtër të projektit dhe përfitimet për qytetarët (mbështetur me të dhëna), të dhënat për personin përgjegjës nga komuna për monitorimin e projektit (numri i telefonit për kontakt dhe adresa e e-mail-it), si dhe kontaktet për raportimin e ankesave të mundshme;

11. Kategoria "Urbanizëm" përmban informata për dokumentacionin urbanistik dhe projektues të komunës, si p.sh.: plani i përgjithshëm urban, planet e detajuara urbanistike, dokumentacioni lokal urbanistik për fshat dhe ngjashëm, me një tregues të qartë për statusin e dokumentit, d.m.th nëse është në fazën e propozimit apo është miratuar, vegëz deri tek organi konsultativ për urbanizëm, raport vjetor për lejet e lëshuara për ndërtim, raport vjetor për aplikimet e paraqitura për legalizimin dhe objektet e legalizuara, ekstrakt nga regjistri i drejtuesve të objekteve të banimit në territorin e komunës me një kontakt si dhe formulari për paraqitje të pakënaqësisë së qytetarëve me punën e drejtuesve, regjistri i objekteve me certifikatë për karakteristikat energjetike të ndërtesës, evidencë elektronike e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera të infrastrukturës, numra për shënimin e objekteve dhe ngjashëm. Informatat mund të jenë të organizuara në disa nënkategori, në bazë të ngjashmërive.

12. Kategoria "Zhvillimi ekonomik lokal" përmban të dhëna për personat juridikë në territorin e komunës që kanë ndikim në zhvillimin ekonomik lokal dhe për të cilët komuna, sipas ligjit, është e detyruar të mbajë regjistër si dhe të dhëna të tjera që pasqyrojnë drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë potencialin zhvillimor të komunës dhe mund të rrisin interesin për të investuar në komunë apo për tërheqjen e vizitorëve dhe turistëve. Për këtë qëllim publikohet një regjistër i veprimtarive tregtare me vëllim të vogël, regjistër i aktiviteteve të hotelierisë në shkallë të vogël, regjistër i aktiviteteve turistike në shkallë të vogël, shërbime në turizmin rural, etnik dhe ekologjik, zona industriale dhe ekonomike, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme që janë pronë e komunës, informacione për iniciativat e ofruara nga komuna për mbështetjen e sektorit afarist si dhe informacione për mënyrën e vendosur të bashkëpunimit aktiv publiko-privat, p.sh. këshilli ekonomik vendor, bordi këshillues, këshilli i biznesit ose të ngjashme. Informatat mund të jenë të organizuara në më shumë nënkategori, në bazë të ngjashmërive.

13. Kategoria "Mjedisi jetësor" përmban informacione dhe akte të kompetencës së komunës në fushën e mjedisit, si planet e mbrojtjes së mjedisit, regjistri i ndotësve në territorin e komunës, lejet mjedisore të ndara B të integruara, qendrat për mbledhjen e mbeturinave elektrike, leje të dhëna për largimin e automjeteve të dëmtuara ose që janë në defekt nga rrugët lokale, deponitë në territorin e komunës/qytetit të Shkupit. Informatat mund të jenë të organizuara në disa nënkategori, në bazë të ngjashmërive.

14. Kategoria "Kultura dhe sporti" përmban informacione themelore për të gjitha objektet nga sfera e kulturës në territorin e komunës/qytetit të Shkupit, pavarësisht nëse menaxhimi i objekteve është përgjegjësi lokale, me orar të punës, çmimet e biletave dhe kontakti, një

ekstrakt nga regjistri i përkujtimeve në territorin e komunës si dhe informacion bazë për të gjitha objektet sportive në territorin e komunës me shërbimet që ofrojnë, çmimet e shërbimeve dhe kontaktin. Informatat mund të jenë të organizuara në bazë të disa nënkategorive, në bazë të ngjashmërive të tyre.

15. Kategorija "**Mbrojtja sociale**" përmban informata për kushtet e ushtrimit të së drejtës së ndihmës sociale nga komuna për kategori të ndryshme të qytetarëve, si p.sh. kushtet për marrjen e ndihmës financiare të njëhershme për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve, në rast të një fatkeqësie elementare, për një fëmijë të porsalindur dhe shërbime të tjera, formularët për paraqitjen e kërkesës për ndihmë financiare të njëhershme, etj. Gjithashtu në këtë kategori publikohen informata rreth shtëpive të pleqve që janë publike (me emrin e objektit, kontaktin, kapacitetin, vendet e lira), qendrat e strehimit (kontakti ku mund të raportohet dhuna), qendrat e kujdesit ditor për personat me aftësi të kufizuara si dhe kontakti dhe vegëza që çon tek Qendra për mbrojtje sociale që ushtron veprimtarinë në territorin e komunës. Informatat mund të jenë të organizuara në disa nënkategori, në bazë të ngjashmërive.
16. Kategorija "**Arsimi dhe mbrojtja e fëmijëve**" përmban informacion për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në territorin e komunës, si dhe kopshtet publike me të dhëna për emrin e institucionit, adresën, kontaktin, drejtorin, numri i përgjithshëm i nxënësve/të ndarë sipas gjinisë, numri i paraleleve sipas klasës, numri i fëmijëve/nxënësve - i ndarë sipas gjinisë, numri i të punësuarve (mësimdhënës dhe të tjerë), gjuhët e mësimi, informacioni për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve, duke përfshirë veglën për procedurën elektronike për regjistrim/përshkrim si dhe informacion aktual për nxënësit dhe prindërit. Informatat në këtë kategori preferohet që të jenë të grupuara në tre nënkategori dhe atë: **mbrojtja e fëmijëve; arsimi fillor; dhe arsimi i mesëm.**
17. Kategorija "**Ndërmarrje publike**" përmban informata për të gjitha ndërmarrjet publike të themeluara nga komuna me të dhëna për emrin e ndërmarrjes publike, veprimtarinë që kryen, shërbimet që ofron, drejtorin e NP me detaje kontakti, anëtarët e bordit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës, programin vjetor të punës së NP-së, raportin vjetor për performancën financiare të NP-së, si dhe një vegëz që çon në faqen e internetit të NP-së. Nëse NP nuk ka ueb faqen e vet, çmimet e shërbimeve të ofruara nga NP si dhe formulari për raportimin e një problemi nga qytetarët dhe të gjitha publikohen në faqen e komunës.
18. Kategorija "**Komuna dhe qytetarët**" përmban informata për mënyrën se si komuna komunikon me qytetarët me një mjet elektronik që mundëson edhe komunikim të drejtpërdrejtë elektronik midis qytetarëve dhe komunës, informata për organizatat aktive të shoqërisë civile që veprojnë në territorin e komunës dhe në rajonin planor, procedura e komunës për bashkëpunim/financim të projekteve të organizatave të shoqërisë civile, projektet aktuale të realizuara nga komuna në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, raporti vjetor për konsultimet e kryera, bashkëpunimi i realizuar dhe projekte të realizuara apo filluara me organizatat e shoqërisë civile me implikime financiare, si dhe formular për paraqitjen e iniciativave qytetare apo të organizatave të shoqërisë civile deri tek komuna. Për këtë qëllim,

informacioni i kësaj kategorie mund të organizohet në dy nënkategori, "**Këshillime me qytetarët**" dhe "**Organizatave civile**", të cilat përfshijnë informatat dhe veglat e mëposhtme:

- Mënyra e konsultimit me qytetarët dhe mjeti elektronik për konsultim me procedurë për veprim;
- Aktet dhe procedurat për sigurimin e mbështetjes financiare të projekteve nga organizatat e shoqërisë civile;
- Regjistri i organizatave aktive të shoqërisë civile në komunë dhe rajonin planor dhe fushëveprimi i tyre i punës;
- Projektet që komuna i realizon në partneritet me organizatat e shoqërisë civile;
- Formular për paraqitjen e iniciativave dhe të ngjashme.

19. Kategoria "Qasje e lirë në informatat publike" është e dukshme në ballinën e ueb faqes të shënuar me një banderolë dhe përmban informata për personin zyrtar (emri dhe mbiemri, emaili për kontakt, telefoni, numri i zyrës), lista e informatave me karakter publik, në përputhje me nenin 10 të Ligjit për qasje të lirë në informatat publike dhe Kodi i transparencës në nivel lokal. Lista përmban të gjitha informatat që publikohet në faqen e internetit, me një vegëz deri tek informata e publikuar ose të paktën deri te kategoria e informatave dhe ofron qasjen më të lehtë dhe më të shpejtë deri tek informata e kërkuar. Detyrimisht publikohet edhe formulari për paraqitjen e kërkesës si dhe vegëza deri tek Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë tek informatat e karakterit publik <https://aspi.mk/> .

Për të mundësuar qasje më të lehtë në informatat dhe shërbimet e ofruara nga komuna, në këtë kategori mund të publikohen edhe informatat për **personin zyrtar për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara** (emër dhe mbiemër, kontakt me e-mail, telefon, numër i zyrës), për **personin zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale** (emri dhe mbiemri, kontakti me email, telefoni, numri i zyrës), **për personin zyrtar për të rinjtë** (emri dhe mbiemri, kontakti i emailit, telefoni, numri i zyrës) dhe zyrtarë të tjerë të ngjashëm specifikë të komunës.

20. Kategoria "Politika e integritetit" përmban të gjitha informatat që garantojnë transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në punën e organeve komunale dhe administratës komunale në përputhje me Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe dokumentet e brendshme të krijuara nga komuna me qëllim të sigurimit të integritetit në punën e organeve komunale dhe administratës komunale. Për këtë qëllim, në këtë kategori publikohen informata për personin zyrtar për integritet, personin përgjegjës (të autorizuar) për pranimin e paraqitjeve të dorëzuara për raportim të brendshëm, kodin e etikës për zyrtarët lokalë, kodin për zyrtarët administrativ, politika e integritetit të komunës, plani vjetor për trajtimin e rreziqeve të identifikuar për korrupsion dhe konflikt interesi, raporti për vlerësimin e zbatimit të planit, formulari për raportimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, akti i komunës për pranimin dhe trajtimin e dhuratave për kryetarin e komunës, anëtarët e këshillit dhe administratës komunale, sipas Ligjit për punëtorët në sektorin publik (neni 39) dhe Kodit për persona të zgjedhur në NJVL, formulari për raportimin e dhuratave të pranuar, akti për regjistrimin e dhuratave të pranuar, vegëza deri tek prokurimet publike, thirrjet publike dhe konkurset për

punësim si dhe fletët e anketimit të bartësve të funksioneve, të publikuar në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

21. Kategoria **"Marrëdhëniet me publikun"** përmban të gjitha informatat që komuna ndan me qytetarët në baza ditore (shpallje ngjarjesh, promovime projektsh, dokumente strategjike, njoftime, apele etj.). Në këto përmbajtje, theksi është vënë në përfitimet e qytetarëve dhe në implikimet financiare mbi buxhetin e komunës. Janë të dukshme në ballinën e ueb faqes. Për një shikueshmëri më të madhe, informatat mund të organizohen në disa nënkategori, si **"Lajme"**, **"Kontakt informata për personat përgjegjës për marrëdhëniet me publikun"** dhe të ngjashme.
22. Kategoria **"Informata për shërbimet"** përmban informata që lehtësojnë përdorimin e disa shërbimeve të ofruara nga komuna dhe përmirëson efikasitetin, si informacioni për përdorimin e transportit publik (rrugët e transportit, objektet, oraret e nisjes, çmimi i biletave, transportuesit e licencuar dhe mjetet motorike të regjistruara për transportin e udhëtarëve dhe mallrave në komunikacionin rrugor), tregjet në territorin e komunës/qytetit të Shkupit, parkingjet në territorin e komunës/qytetit të Shkupit (lokacioni, me pagesë, falas, hapësira të shënuara për personat me aftësi të kufizuara, çmimi i shërbimit), shërbimi zjarrfikës, stacioni policor, ndihma e shpejtë, objektet shëndetësore në territorin e komunës, njësitë rajonale të Agjencisë për punësim dhe shërbime të ngjashme. Kjo kategori mund të përmbajë edhe informata kontakti nga institucione dhe zyra të tjera të rëndësishme për qytetarët, si zyrat mobile të komunës, zyrat për rini, klubet e pensionistëve, njësitë rajonale të ministrive në territorin e komunës, stacioni për kafshët shtëpiake dhe informacione të tjera të dobishme. Në faqen e internetit mund të publikohen informacione nga subjektet tregtare që konsiderohen me interes publik ose informacione për ngjarje të organizuara nga subjekte të tjera publike, të cilat mbahen në territorin e komunës.
23. Kategoria **"Të dhëna të hapura"** përmban vegëzat deri tek të gjitha të dhënat në faqen e internetit të komunës që janë publikuar në format të hapur, në përputhje me Ligjin për përdorimin e të dhënave nga sektori publik.
24. Kategoria **"Kontakti me komunën"** përmban të dhëna kontakti nga komuna, si adresa, telefoni dhe numri i telefonit zyrtar nga sekretari i komunës, e-maile zyrtare nga komuna dhe sekretari i komunës dhe një formular për komunikim të drejtpërdrejtë elektronik me komunën.
25. Kategoria **"Vegëza të dobishme"** përmban të gjitha vegëzat që do të ishin të dobishme për komunën, si vegëzat për Qendrën për zhvillimin e rajonit planor, për Ministrinë e vetëqeverisjes lokale, me Byronë për zhvillim rajonal, për Inspektoratin shtetëror për vetëqeverisje lokale dhe vegëza të tjera.

Mënyra e publikimit të të dhënave dhe informacionit

Neni 12

Të dhënat dhe informatat publikohen në mënyrë që të sigurohet dukshmëria dhe qasja në internet në mënyrën më të lehtë dhe më të shpejtë të mundshme.

Kategoritë e informatave janë të dukshme në menynë kryesore ose në banderola në ballinën e ueb faqes.

Nënkategoritë janë të qasshme me një klikim të dytë.

Qasja në të gjitha informacionet e tjera sigurohet deri në klikimin e tretë.

Rekomandohet përmbushja e nivelit AA për qasje në ueb, në mënyrë që të sigurohet qasje e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara të cilët përdorin teknologjitë ndihmëse për të punuar me kompjuterë dhe internet³.

Të dhënat e publikuara në faqen e internetit publikohen të ndara sipas gjinisë, kudo që të jetë e mundur.

Neni 13

Të dhënat që publikohen në faqen e internetit, gjithnjë kur kjo është e mundur, publikohen në format të hapur të përpunueshëm nga kompjuteri (të paktën në tabelën Excel), në përputhje me Ligjin për përdorimin e të dhënave nga sektori publik.

Të dhënat dhe dokumentet që publikohen në faqen e internetit në WORD duhet të paktën të jenë të hapura me mundësi kopjimi.

“Të dhëna nga sektori publik” janë të dhënat që i krijojnë organet dhe institucionet nga sektori publik, përfshirë edhe komunitat gjatë punës së tyre në përputhje me kompetencat ligjore.

"Format i përpunueshëm nga kompjuteri" nënkupton një format dokumenti të strukturuar në atë mënyrë që aplikacionet softuerike të mund të identifikojnë, njohin dhe nxjerrin lehtësisht të dhëna specifike prej tij, duke përfshirë pjesët e veçanta të të dhënave dhe strukturën e tyre të brendshme, dhe mundëson përpunimin automatik të tyre.

"Format i hapur" nënkupton një të dhënë që është e pavarur nga platforma dhe e disponueshme për publikun pa asnjë kufizim që do të pengonte përdorimin e të dhënave.

Me kohë dhe gabimet

Neni 14

Të dhënat duhet të publikohen menjëherë pas krijimit të tyre.

Të dhënat duhet të jenë sa më të sakta që të jetë e mundur gjatë publikimit për herë të parë.

Megjithëse mund të ndodhin gabime, publikimi i informatave nuk duhet të stërzgjetet për të korrigjuar gabimet. Kjo ka të bëjë me gabimet në saktësinë e të dhënave, veçanërisht nëse vlen për të dhëna të mëdha me gabime jo thelbësore, si për shembull dhjetoret etj.

³ <https://www.w3.org/WAI/intro/wcag>

Aty ku zbulohen gabime të të dhënave ose ndryshohen skedarët për arsye të tjera (siç janë lëshimet), duhet të publikohen informata të reviduara, duke shpjeguar qartë se ku dhe si është bërë ndryshimi.

Mbrojtja e të dhënave personale

Neni 15

Gjatë publikimit të informatave dhe të dhënave në faqen e internetit, kihet parasysh mbrojtja e të dhënave personale, në përputhje me ligjin.

"Të dhëna personale" është çdo informatë që lidhet me një person fizik të identifikuar ose një person fizik të identifikueshëm.

Personi i identifikueshëm është personi, identiteti i të cilit mund të përcaktohet drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht në bazë të numrit të identifikimit të shtetasit ose në bazë të një ose më shumë veçorive specifike për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social.

Në faqen e internetit mund të publikohen të dhëna personale të përpunuara.

"Përpunim i të dhënave personale", ndër të tjera, nënkupton publikimin ose në mënyrë tjetër (me mbulimin e numrit personal ose të dhënave të tjera specifike) vënien në dispozicion të të dhënave personale, në kushtet e mëposhtme:

Pas pëlqimit të marrë më parë nga subjekti për të dhënat personale; Për realizim të një kontrate në të cilën subjekti i të dhënave personale është palë kontraktuese ose me kërkesë të subjektit të të dhënave personale, përpara se të lidh kontratën; Për përmbushje të detyrimit ligjor të kontrollorit; Për të mbrojtur jetën ose interesat thelbësore të subjektit të të dhënave personale; Për të kryer çështje me interes publik ose me autorizim zyrtar të kontrolluesit ose një pale të tretë të cilit i janë zbuluar të dhënat ose për të përmbushur interesat legjitime të kontrolluesit, të një pale të tretë ose të një personi të cilit i janë zbuluar të dhënat, përveç rasteve kur liritë dhe të drejtat e subjektit të të dhënave personale nuk i tejkalojnë këto interesa.

Personi përgjegjës për menaxhimin e informatave

Neni 16

Përgjegjës për sigurimin transparencës aktive të komunës dhe për zbatimin e Kodit të transparencës në nivel lokal është personi zyrtar për sigurimin e të drejtës për qasje të lirë në informata të natyrës publike ose një person tjetër i emëruar nga kryetari i komunës (në tekstin e mëtejme personi përgjegjës).

Neni 17

